



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:170870

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500535

P.nr.21/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit B.B me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1515/23 e datës 30.01.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 21.03.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Muharrem Prekazi, i pandehuri B.B dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.Gani Rexha, më dt.21.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: B.B me nofkën “N” nga i ati H., e ëma Gj., e gjinisë M., i lindur më datë ... komuna e Vushtrrisë, me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i divorcuar, prind i një fëmiu, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa gjykuar me vendim të plotfuqishëm në bazë të evidencës penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Prej datës së pa vërtetuar e deri më datë 07.08.2023, rreth orës 03:10 minuta, në rrugën “F.B” në Vushtrri, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët, pa autorizim ka poseduar armën e llojit Girson, prodhim turk, me numër serik T6368-21RU01417 MC P35 9X19 MM, një karikator ngjyrë e zezë e armës përkatëse me 15 fishekë, shufër metali, maskë e fytyrës ngjyrë e zezë, dorëza të lëkurës ngjyrë të zezë, bateri ndriçuese e dorës dhe një thikë, sende të cilat i ishin gjendur në trup të pandehurit pas kontrollimit nga ana e policisë,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 366 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 277, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: B.B i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumë prej 3400 € (tre mijë e katërqind euro) , i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET- Konfiskimi i përhershëm i armës së llojit Girson, prodhim turk, me numër serik T6368-21RU01417 MC P35 9X19 MM, e cila armë mund të përdoret nga Policia e Kosovës, pas verifikimit, një karikator ngjyrë e zezë e armës përkatëse me 15 fishekë, shufër metali, maskë e fytyrës ngjyrë e zezë, dorëza të lëkurës ngjyrë e zezë, bateri ndriçuese e dorës dhe një thikë.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1515/23 e datës 30.01.2024, kundër të pandehurit B.B nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.21.03.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që:

I pandehuri B.B ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë, gjykatës i propozon që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, ndërsa të merret parasysh si rrethanë rënduese fakti se i pandehuri edhe para gjykatës ka konfirmuar se është i dënues për natyrën e njëjtë, andaj nga këto arsye në kuptim të nenit 38 të KPRK-së dhe nenit 69 dhe 70, i propozon gjykatës që të marr parasysh edhe rrethanat tjera lehtësuese dhe rënduese dhe të shqiptojë një dënim adekuat me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av. Gani Rexha lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij dhe të shqiptojë një dënim sa më të butë.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Procesverbal i marrjes në pyetje i të pandehurit B.B në procedurën paraprake i dt.26.01.2024, Raport informues i dt.12.08.2023, Urdhër kontroll i dt.10.08.2023, Procesverbale për kontroll dhe sekustrim të përkohshëm të dt. 12.08.2023, Raport fillestar i incidentit nr.2023-BD-678 i dt. 07.08.2023, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.B i dt.07.08.2023, Foto dokumentacion në shtojcë prej 7 foto, Lista e dëshmitëve, Vërtetim mbi armën e konfiskuar i dt. 07.08.2023, Vërtetim mbi sekustrimin e sendeve i dt.07.08.2023, Raport i policit i dt. 07.08.2023, Raport policor i dt.07.08.2023, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumë prej 3400 € (tre mijë e katërqind euro), është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Urdhrin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet, si dhe nenin 277 par 6 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.21/2024, datë 25.03.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.